



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

OSHP:2024/0471
Data e vendimit:31.05.2024

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenit 109 paragrafi 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenit 17 paragrafi 6 i Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik OE “CONSTRUMAX” SH.P.K. kundër njoftimit për kontratë respektivisht dokumenteve të tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “97 Ndërtimi i nënkalimit për vetura në rrugën Agim Ramadani” me numër të prokurimit 616-24-3786-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, ud. Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit me datën: 31.05.2024, mori këtë:

VENDIM

- I. Hedhet si e jashtafatshme**, ankesa “CONSTRUMAX” SH.P.K. me nr. të protokollit 2024/0471, e datës 30/05/2024, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “97 Ndërtimi i nënkalimit për vetura në rrugën Agim Ramadani”, me numër të prokurimit 616-24-3786-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës.
- II. I lejohet**, autoritetit kontraktues – Komuna e Prishtinës që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “97 Ndërtimi i nënkalimit për vetura në rrugën Agim Ramadani” me numër të prokurimit 616-24-3786-5-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

ARSYETIM

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Me 19.04.2024, “Komuna e Prishtinës” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05-Njoftimin për kontratë, ku sipas këtij njoftimi afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë data: 15.05.2024.

Me 14.05.2024, “Komuna e Prishtinës” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara ku sipas këtij njoftimi afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë data: 24.05.2024.

OE “CONSTRUMAX” SH.P.K. me 16.05.2024 në ora 21:15 OE ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së. Ndërsa me datë 20.05.2024 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Operatori ekonomik i pakënaqur me vendimin e AK - “CONSTRUMAX” SH.P.K ka parashtruar ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit, përmes sistemit e-prokurimit me datën 30.05.2024 ora 16:56.

- Administrimi dhe Vlerësimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit “97 Ndërtimi i nënkalimit për vetura në rrugën Agim Ramadani” me numër të prokurimit 616-24-3786-5-1-1, në cilësinë e autoritetit kontraktues (AK) “Komuna e Prishtinës” datën 19.04.2024 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05. Ndaj këtij njoftimi është paraqitur kërkesë për rishqyrtim nga operatori ekonomik ankues me datën 16.05.2024 ndërsa me datën 20.05.2024, AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik si të pa bazuar.

Meqë AK - “Komuna e Prishtinës” me datën 20.05.2024 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues, afati ligjor për të paraqitur ankesë në OSHP ka filluar të rrjedhë nga data 21.05.2024, respektivisht pala e pa kënaqur ka pasur të drejtë të parashtojë ankesë brenda 10 ditëve.

Zyra për pranimin e ankesave pas pranimit të ankesës ka konstatuar se operatori ekonomik ankues OE “CONSTRUMAX” SH.P.K ka parashtruar ankesë në sistemin e-prokurimi me datën 30.05.2024. ora 16:56.

OE ankues ka qenë i obliguar që në pajtim me paragrafin 2 të nenit 109 të LPP-së, brenda afateve ligjore të parashtruar ankesë në OSHP, pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK.

Neni 109 paragrafi 2 i LPP-së përcakton se *Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.*

Po ashtu, edhe neni 64.1 në Rregulloren 001/2022 për Prokurim Publik përcaktohen se: *Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të nxjerrë nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-së.*

-Përfundimi-

Konstatohet se ankesa e parashtruar në sistemin e-prokurimi me datën 30.05.2024 nga OE “CONSTRUMAX” SH.P.K për aktivitetin e prokurimit me titull: “97 Ndërtimi i nënkalimit për vetura në rrugën Agim Ramadani” me numër të prokurimit 616-24-3786-5-1-1, është e jashtafatshme sepse ankuesi nuk ka parashtruar ankesën brenda afateve ligjore kundër njoftimit të Autoritetit Kontraktues. Andaj Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se pas udhëheqjes së një procedure paraprake të rregullt dhe brenda afateve ligjore, ankuesi mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së.

Si përfundim kjo ankesë është në kundërshtim me nenin 109 të Ligjit për Prokurim Publik, dhe nenit 64 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, dhe si e tillë hedhet si e jashtafatshme dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

Ud. Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-se, duke u bazuar ne atë qe u tha si me lartë vendosi si ne dispozitiv te këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimiit te vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – “Komuna e Prishtinës”

1x1 OE - “CONSTRUMAX” SH.P.K

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së

Agim SHEQIRI
Ud. Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së

